




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 729/25
Data: 03.07.24



Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2215_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; Nenin 3, 4, 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, e pranuar me datë 28.06.2024 nga aplikuesi personi juridik "GOETZ ENTERPRISES SAS", me adresë: Rr. "Magj- Podujevë- Merdare" Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 01 korrik 2024 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa dhe miratohet Statusi i Prosumatorit aplikuesit "GOETZ ENTERPRISES SAS", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Podujevës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "GOETZ ENTERPRISES SAS", me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR - 90134457 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "GOETZ ENTERPRISES SAS", do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 7 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme.

A r s y e t i m

- ZRRE, me datë 28.06.2024 nga aplikuesi "GOETZ ENTERPRISES SAS", ka pranuar aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Podujevës.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të



instaluar, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 8361 të datës 24.06.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 07-354/07-0028982/24 të datës 22.05.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrotje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.

- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "GOETZ ENTERPRISES SAS", dhe dëshmime të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosumtorti dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Podujevës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Artë Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.